

VENDIM
Nr. 720, datë 1.12.2017

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË SË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA NDËRTIMI I LINJËS SË
TRANSMETIMIT 110 kV MEMALIAJ-GJIROKASTËR, SHTYLLA LIDHËSE ME
NËNSTACIONIN GJIROKASTËR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, me numër 193/6, në ZK 8541, të llojit tokë bujqësore-arë, me sipërfaqe 43.6 m², në Gërhoh-Virua, Bashkia Gjirokastrë, në emër të z. Mesemi Rrapa, me çmim të konfirmuar nga ATP-ja 4 865 (katër mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekë/m², që preket nga ndërtimi i linjës së transmetimit 110 kV Memaliaj-Gjirokastrë, shtylla lidhëse me nënstacionin Gjirokastrë.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a.

3. Pronari i pasurive të paluajtshme, që shpronësohet, të kompensohet në vlerë të plotë, sipas vlerës përkatëse të kompensimit, në shumën prej 212 114 (dyqind e dymbëdhjetë mijë e njëqind e katërbëdhjetë) lekësh, për sipërfaqen prej 43.6 m² tokë bujqësore-arë.

4. Fondi i kompensimit dhe të gjitha shpenzimet e tjera procedurale do të përballohen nga fondet e OST sh.a., si subjekti që garanton shpenzimet për realizimin këtij procesi.

5. Shpronësimi të fillojë brenda muajit dhjetor 2017.

6. Procedura e kompensimit për pronarin të bëhet me paraqitjen e kërkesës dhe dokumentacionit të pronësisë pranë OST sh.a.

7. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Gjirokastrë të marrin masat për pezullimin e të gjitha transaksioneve mbi këtë pasuri, deri në përfundim të procesit të kalimit të pronësisë së pasurisë së shpronësuar në favor të OST sh.a.

8. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, OST sh.a. dhe zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi